



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0397

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-Kryetarë, Vedat Poterqoi-Refrues dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Sallahu" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, “Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, Prishtinë- Besi - Podujevë, Loti 0,1, 2, 3 dhe strukturat Lot 5” me numër të prokurimit 205-23-21-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës, më 04/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e OE "SALLAHU" SH.P.K. me nr. 2023/0397, e datës 15.06.2023 dhe mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënie të kontratës, i komunikuar me njoftimin e datës, 09.06.2023, për aktivitetin e prokurimit me titull “Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, Prishtinë- Besi - Podujevë, Loti 0, 1, 2, 3 dhe strukturat Lot 5” me numër të prokurimit: 205-23-21-5-1-1”

2. Të iniciohet procedura për për revokim të certifikatës ndaj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, për shkak të shkeljeve të evidentuara si më poshtë në arsyetimin e këtij vendimi, konform paragrafit 9, neni 25, i LPP.

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës ndaj Operatorit Ekonomik "SALLAHU" SH.P.K, konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.01.2023, Ministria e Infrastrukturës në cilësinë e AK ka paraqitur njoftimin B05 për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i rrugës Nacionale N25, Prishtinë- Besi - Podujevë, Loti 0,1,2 , 3 dhe strukturat Lot 5.”, me numër të prokurimit 205-23-21-5-1-1.

Ndërkaq me datën 31.05.2023 është publikuar B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, vlera e parashikuar e kontratës: 37,599,981.94€ .

Me 05.06.2023, OE "SALLAHU" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK, e e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 08.06.2023, me arsyetimin se “ ...nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatoreve ekonomik, atëherë i vetmi OE i cili është autorizuar për të vepruar në emër të grupit është ai OE i cili është autorizuar si partner udhëheqës konform deklaratës ose marrëveshjes për krijimin e grupit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit dhe e cila është obliguar për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit...”

Me 15.06.2023, OE "SALLAHU" SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP (numër protokolli 397/23) kundër vendimit të cituar si më sipër të AK.

- Shqyrtimi paraprak -

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e parapara me nenin 111 dhe është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP, pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve sikurse kërkohet në kuptim të nenit 108/A të Ligjit të cituar. Meqë ankesa është ushtuar nga OE i cili e ka statusin e palës së interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 dhe i plotëson kushtet e parapara me nenin 105 të LPP konstatohet se e njëjta bije në kompetencat e këtij Organi për shqyrtim dhe vendosje.

Bazuar në nenin 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues me 25/07/2023 për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili me 23/08/2023 ka dorëzuar raportin e ekspertizës me rekomandimet si në vijim: “ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.” Raporti i ekspertizës është pranuar nga palët për të cilin AK nuk është deklaruar ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova të gjuha shkresat e kësaj lënde, përfshirë raportin e ekspertit, aktet dhe pohimet e palëve dhe provat e propozuara nga palët lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 2 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh se pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në këtë rast, gjatë administrimit të shkresave të kësaj lënde, konstatohet se:

Ankuesi, ka pohuar se ka parashtruar kërkesë për qasje në ofertat e ofertuesve të rekomanduar dhe dëshmitë e pranueshmërisë së OE të rekomanduar, me ç ‘rast AK nuk i ka dhënë qasje. Si rrjedhojë, ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim e cila nuk po ashtu është shqyrtuar por është njoftuar nga AK se është cilësuar palë pa interes kryesisht bazuar në arsyetimin se kërkesa është bërë nga ana e anëtarit të konzorciumit dhe si e tillë nuk është marrë si i mirëqenë.

Ankuesi na shpjeguar më tej se pas pranimin të Njoftimit mbi Vendimin e AK, duke konsideruar se është palë me interes në kuptim të nenit 4 të LPP-së paragrafi 1.11 lidhur me 1.26, me 31.05.2023 në përputhje me nenin 10 dhe 11 të LPP-së dhe 7 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ka parashtruar Kërkesë për qasje në dokumente drejtuar Zyrës së Prokurimit

pranë MMPHI në platformën elektronike, e-prokurim dhe e-mail. Duke theksuar me tej se veprime të tilla të pa përgjegjshme dhe në kundërshtim me parimet e LPP-së, Zyrtarët e MMPHI kanë cenuar lirinë e qasjes në dokumente zyrtare në kundërshtim me nenin 10 të LPP-se. Sipas Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 97.1 pika c) si shkelje e rëndë konsiderohet: Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik. Ankuesi ka pohuar se “me 08.06.2023 ka pranuar Përgjigjen refuzuese ndaj Kërkesës për Rishqyrtim të datës 05.06.2023 dhe se Zyra e Prokurimit pranë MMPHI nuk ka respektuar rregullat për trajtimin e Kërkesave për Rishqyrtim, me ç’rast këto veprime cilësohen si shkelje e rëndë konform nenit 97 pika E të Rregullores nr. 001/2023 për Prokurimin Publik.”

Eksperti shqyrtues, ka shpjeguar se me 28.07.2023 ka kërkuar interpretim në KRPP për dispozitat ligjore të nenit 71 të LPP-së dhe nenit 26 të RRPP-së, lidhur me autorizimin ankuesit, nga cilësia e tij si anëtar i konzorciumit, ku KRPP lidhur me autorizimin jep opinion për OSHP me dt. 17.08.2023;

” Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L0237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara (të lartë cituara), KRPP sqaron dispozitat e LPP dhe të legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, si në vijim:

Lidhur me pyetjen tuaj, KRPP ofron këtë sqarim të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik:

Rregulla për Grupin e Operatorëve Ekonomik, përcakton neni 71 i LPP-së dhe neni 26 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (këtu e tutje “RRPP”).

Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 26 të RRPP, përcaktojnë:

“26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet të:

- a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;
- b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);
- c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; dhe

d. Secili anëtar i grupit duhet të jetë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit. (Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP);

26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument”.

“Partneri udhëheqës” i përmendur në pikën c) më lartë, nënkupton ‘Liderin’ të cilën përmes një deklarate anëtarët e konzorciumit e autorizojnë për të vepruar në emër të grupit dhe kjo deklarata së bashku me dy deklaratat tjera të përmendura në pikën a) dhe b) më lartë, si dhe Marrëveshja për krijimin e grupit duhet të jenë pjesë e dokumenteve (dëshmime) tjera të dorëzuara me ofertë nga grupi i OE-ve në përputhje me kërkesat e specifikuar nga AK në FTD (Fletën e të dhënave të Tenderit) të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Rrjedhimisht, Deklarata nën pikën c) më lartë, kërkohet në FTD të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë me qëllim që t’i bëhet e ditur AK-së se cili nga anëtarët e konzorciumit do të jetë lideri i grupit, i cili do të veprojë në emër të grupit në rast të ndonjë sqarimi të mundshëm të ndonjë pjese të tenderit gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, dhe më gjerë për të përfaqësuar grupin e OE-ve në raport me AK-në (në rast të paraqitjes së kërkesës për qasje apo në rast të parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim të vendimit të AK-së), apo në raport me OSHP-në (në rast të parashtrimit të ankesës në OSHP kundër Vendimit të AK-së).”

Dhe meqenëse autorizimi i pa noterizuar si dhe i lidhur me datë të njëjtë me njoftimin e AK-së, nuk rregullohet me LPP, është konsideruar e nevojshme të sigurohet një konfirmim nga Lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomik, i cili me datë 22.08.2023 ka konfirmuar autorizimin në fjalë. Prandaj sa i përket pretendimit të ankues lidhur me shkeljet e AK për refuzim të qasjes në dokumente, Eksperti shqyrtues konsideron se janë të qëndrueshme, për faktin se në momentin kur ankuesi ka kërkuar qasje mbi ofertat e OE të rekomanduara me datën e njëjtë të publikimit të njoftimit (pra me 31.05.2023) po ashtu duke tentuar edhe përmes e-mail me datë 01.06.2023 dhe 02.06.2023, AK nuk i ka dhënë qasje, bazuar në arsyetimin se autorizimi dhe kërkesa në fjalë ka qenë diskutabile për AK. Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar sipas opinionit të KRPP-së sipas të cilit: "Lidhur me kërkesën e parashtruar AK është dashur që nga parashtruesi i ankesës siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LPP-së, të demonstrojë në ankesë se ai kualifikohet si “palë e interesuar” siç përcaktohet në nenin 4 të LPP-së. Për tu kualifikuar si palë e interesuar, parashtruesi i ankesës duhet të dëshmojë se ai ka një interes të veçantë material në rezultatin e një aktiviteti të prokurimit, para se gjithash në fitimin e kontratës dhe se ai është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar.

Në rast konzorciumi, Parashtruesi i Ankesës për të vërtetuar ekzistimin e një interesi të caktuar material për marrjen e kontratës dhe/ose dëmet e mundshme, duhet të provojë se ai vepron në emër të grupit të Operatorëve Ekonomik. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktues duhet të veprojë në pajtim me Rregulloren nr.001/2022 për prokurim publik, neni 61 paragrafi 61.2, sipas të cilit

“Nëse mungon ndonjë nga elementet e përmendura në nenin 60.2 të kësaj rregullore, Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësoj kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtuesi i kërkesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishqyrtim do të refuzohet si e paplotë.”Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës në e-prokurim gjegjësisht datat, sqaron se AK në e-prokurim fillimisht me datë 31.05.2023, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin, pastaj me datë 09.06.2023 ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës ndërsa me datë 19.06.2023 janë nënshkruar kontratat. Kurse Ankesa në OSHP është dorëzuar pranuar me datë 15.06.2023, gjë që pretendimikonsiderohet i bazuar për faktin se nuk është pezulluar aktiviteti si dhe janë nënshkruar kontratat.

Më tej, sa i përket pretendimit ankues lidhur me arsyen e eliminimit nga AK, Eksperti shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE ankuesit sqaron se në bazë dokumenteve unike doganore/DUD (të cilat disa shihen dhe disa nuk shihen fare) OE ankuesi posedon një Greder sipas kërkesës AK-së, dhe një është 16.2 T, ndërsa tjerat nuk shihen qartë në DUD, kurse sa i përket pretendimit se pajisja me radhë nr. 3 në listë në bazë të dëshmive të bashkangjitura është grejderi i vitit të prodhimit 1993, e cila në bazë të hulumtimeve në internet këto pajisje dallojnë me specifika dhe tonalitet në bazë të vitit të prodhimit. Po ashtu sa i përket arsyes së eliminimit të OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të praktikave ka raste kur AK ofrimet e tilla i konsideron si devijime të vogla, mirëpo ato raste janë kur operatori OE është me i lirë në oferte, si dhe nëse njësia kërkuese e konsideron të mirëqenë, pra është diskrecion i AK-së. Andaj lidhur me pretendimet e ankuesit për shqyrtimin e ofertave të operatorëve ekonomik të rekomanduar, për të cilat nuk ka pretendime konkrete në ankesë, nuk ka mundur të jep mendim. Si përfundim, eksperti shqyrtues duke u gjendur në situatë të tillë, sipas dispozitave ligjore të nenit 132 par.1 dhe 1.2, par 2, 2.1 dhe 2.4 dhe par. 3. të LPP-së:

1. Kontrata publike ose konkursi i projektimit mund të shfuqizohet pjesërisht ose plotësisht nga OSHP ose një gjykatë, nëse të përmendurit konstatojnë se kontrata publike ose konkursi i projektimit:

1.2. ishte përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontratës;

2. Në rast se OSHP ose një gjykatë konstaton se një kontratë publike ose konkurs projektimi mund të shfuqizohet për shkaqet e përcaktuara në nenin 132.1, OSHP ose gjykata mund të nxjerrë urdhër:

2.1. për shfuqizimin e kontratës publike, pjesërisht ose plotësisht;

2.4. nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuara nga ana e autoritetit kontraktues gjatë aktivitetit të prokurimit, për ta detyruar autoritetin kontraktues që të paguajë dëmet e shkaktuara cilitdo operator ekonomik që është dëmtuar nga shkeljet e tilla.

3. Gjatë vendosjes për shfuqizimin e një kontrate publike ose konkursi të projektimit, pjesërisht ose plotësisht, OSHP ose gjykata duhet të marrin parasysh dëmet në interesin publik që mund të rezultojnë nga ky veprim. Nëse OSHP ose gjykata konstaton se shfuqizimi do të kishte pasoja të rënda në interesin publik, atëherë OSHP ose gjykata nuk do të shfuqizojnë kontratën publike ose konkursin e projektimit, por do të përpiqen ta rregullojnë çështjen përmes nxjerrjes së një urdhri për kompensimin e dëmit sipas nën- paragrafëve 2.3 dhe/ose 2.4 paragrafi 2. të këtij neni.

Pra eksperti ka ardhur në përfundim se për këtë aktivitet të prokurimit veç se janë nënshkruar kontratat si dhe kanë filluar punimet, marrë parasysh dëmet dhe interesin publik, për të cilin mendon se është më i madh nëse shfuqizohet kontrata nga ky veprim, se sa rivlerësimi dhe dhënia e qasjes për OE ankuesin, andaj si e tillë duke u bazuar në këtë fakt pretendimi i OE ankuesit lidhur me shkeljet e përmendura si më lartë konsideron se gjenden të bazuara, ku të cilën ankesë e kualifikon si pjesërisht të bazuar ndërsa rekomandon panelin shqyrtues që vendimi AK-së të mbetet në fuqi. Megjithatë eksperti Shqyrtues ka njoftuar panelin shqyrtues me datën 31.08.2023 si në vijim “eksperti shqyrtues mendon se pjesa e shfuqizimit të kontratave të nënshkruara është në kompetencë dhe përgjegjësi të panelit shqyrtues të OSHP-së të vendos për lëndën/ankesën, dhe si e tillë nuk mund të jap mendim/rekomandim.” Kurse, sa i përket pretendimeve të OE ankues të cilat janë shqyrtuar dhe gjenden të bazuara, lidhur me shkeljet e AK-së siç janë: mos dhënia e qasjes, mos pezullimi i aktivitetit si dhe nënshkrimi i kontratave derisa ankesa është në OSHP, qëndrojnë prapa tyre.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues konsideron se raporti i ekspertit shqyrtues është apriori i bazuar në dokumente relevante, kurse konstatimet e të njëjtit mund të vërtetohen krahas provave që i përmban njëherësh edhe dosja e tenderit.

Mirëpo në kontesktin e këtij raporti paneli vëren se nuk janë ofruar të dhëna të mjaftueshme përkitazi me statusin e ankuesit nga cilësia e tij/saj si palë në procedurë në vështrim të nenit 71 të LPP. Në të vërtetë në kontekstin e kësaj dispozite pa ndonjë dilemë kuptohet se grupi i operatorëve ekonomik nga momenti i fitimit të statusit të palës si grup respektivisht konzorcium, vetëm si të tillë e mbartin atributin e palës edhe gjatë rrjedhës së mëtejme të aktivitetit të prokurimit. Njëherësh në kuptimin e kësaj dispozite është jo kontestues fakti se autorizimet e përfaqësimit i atribuohen liderit të GOE, në të kundërtën ndërmarrja e veprime nga gjithë secili bie ndesh me nocionet dhe parimet themelore të sanksionuara me nenin 71 lidhur me faktin se kush ka të drejtë ta përfaqësojë GOE. Sërish në kontestin e këtyre shpjegimeve paneli konsideron se ndërmarrja e veprimeve nga njëri anëtar i GOE tejkalon autorizimet e tij si anëtar dhe njëherësh tejkalon statusin e palës në procedurë. Në fakt paraqitja e kërkesës për ri-shqyrtim dhe njëherësh ushtrimi i ankesës në OSHP (në kuptim të instancës së dytë) për panelin shqyrtues krijojnë konstatimin se ankuesi nuk është i njëjti subjekt me atë që mbartë subjektivitetin e ofertuesit. Faktet dhe rrethana e tilla shkurtimisht të shpjeguara si më sipër të cilat i referohen ekskluzivisht statusit të palës përbëjnë prezumime të domosdoshme të karakterit procedural lidhur me shqyrtimin e një ankesë. Posaçërisht në këtë rast paneli vëren nga shkresat e kësaj lënde

se me rastin e ushtrimit të kërkesës për ri-shqyrtim, tani ankuesi nuk e ka dorëzuar (version elektronik) autorizimin lëndor gjë që kjo nënkupton faktin se i njëjti një veprim të tillë në instancën e parë e ka ndërmarr pa mandat të liderit. Dhe, përderisa krahas ankesës është dorëzuar në këtë rast autorizimi në OSHP, paneli konsideron se ankesa në këtë rast nuk i plotëson elementet qenësore shprehimisht të parapara me dispozitën e nenit 109 lidhur me nenin 108/A të LPP.

Nisur nga pikëpamja e pavarur e tij, paneli mendon se edhe nëse ankesa në rastin konkret do të ishte e plotë në vështirësi të dispozitave të cituara, megjithatë nga provat në dispozicion vërehet se në raport me kriteret e dosjes së tenderit, ankuesi nuk e ka provuar se disponon me kapacitetin e pamohueshëm teknik dhe njëherësh i njëjti në raport me ofertuesit e rekomanduar është dukshëm me çmim më i lartë. Kjo do të thotë se AK ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 1,6, 27, 28 lidhur me nenin 59 të LPP.

Për më tepër, vërehet nga shkresat e lëndës se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që OE duhet ti ketë 2 grejder 12-16T për LOT 0, ndërsa për LOT 1,2,3, duhet ti ketë 3 Grejder 12-16T. Paneli shqyrtues vëren se në bazë dokumenteve unike doganore (të cilat disa shihen dhe disa nuk shihen fare) ankuesi posedon vetëm një Grejder sipas kërkesës së AK-së i cili ka peshë 16 T. Grejderët e tjerë të ofruar janë: 16.2 T, 17.07 T, 20T ndërsa tjetri nuk shihen qartë dhe për panelin shqyrtues nuk mundet të merret si dokument i vlefshëm. Sa i përket asaj që Ankuesi ka deklaruar se grejderi me kubik prej 16.2 T duhet të merret si devijim i vogël, paneli shqyrtues në konsistencë edhe me vendimet e tjera kur ka të bëjë me specifikime dhe pajisje konsideron se autoriteti kontraktues ka të drejtë ta konstatoj faktin nëse është devijim i vogël në raport me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, konform nenit 59, paragrafi 4 i LPP. Në vijim, vlen të theksohet se paneli shqyrtues, bazuar në parimet bazë të LPP konform nenit 6 të LPP (ekonomiciteti i shfrytëzimit të buxhetit), në këtë rast vëren OE ankues është me çmim dukshëm me te lartë se sa OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, bazuar në të dhënat e krahasuara si në vijim:

	Çmimi i OE fitues	Çmimi i OE ankues	Diferenca ne euro
Lot 0	6,484,854,58	6,608,236.65	123,382.07
Lot 1	8,447,477,70	9,044,195.88	596,718.18
Lot 2	8,644,259.75	9,383,865,85	739,606.10
Lot 3	9,254,811,42	10,578,356.61	1,323,545.19

Totali i diferencës është 2,783,251.54 euro

Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli konsideron në këtë çështje ankimore nuk mund të lëshohet në vlerësimin e pretendimeve lidhur me OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për faktin se ky vendim ka apriori karakter procedural, megjithatë përgjegjësia ligjore mbi vlerësimin dhe rekomandimin e operatorit ekonomik për dhënie të kontratës gjatë një faze të tillë i adresohet AK pasi që ka bërë vlerësimin e përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës gjatë kohës sa kanë qenë në fuqi efektet juridike të pezullimi në kuptim të nenit 112 të LPP. Në raport me këtë, duhet theksuar se sipas nenit 59 paragrafi 1, të LPP thuhet se “Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”. Si dhe në bazë të nenit 24.2 të LPP, I cili citon: “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi lënien në fuqi të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit në rastin konkret duke u nisur kryesisht nga parimi i përgjithshëm i interesit publik duke ju referuar nenit 104 par. 4 pika (iii) të LPP-së, sipas të cilit OSHP duhet të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik. Mirëpo duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104 paragrafi 1 dhe 4, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, Paneli konsideron se megjithatë AK nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e nenit 112 (efekti pezullues i ankesave) dhe se në këtë rast gjen zbatimin aplikimi i masave ndëshkimore ndaj AK në kuptim të nenit 105, paragrafët (2.1; 2.2; 2.15) të LPP sipas të cilit OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi të shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji dhe të hetojnë dhe të përcaktojnë faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla, lidhur me nenin 25, paragrafi 9, të LPP sipas të cilit “në bazë të një kërkesë nga një autoritet kontraktues ose OSHP, KRPP-ja vendos nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit të specifikuar në nenin 23 apo janë bërë shkelje të rënda të këtij ligji ose rregullave të prokurimit për një certifikatë profesionale të prokurimit”. Neni 23 krijon efekt detyrues andaj nënshkrimit i një kontrate përkundër afatit dhe/ose efektit pezullues me rastin e ushtrimit të një ankese, përbën së paku mungesë të etikës profesionale.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- **OE - "SALLAHU" SH.P.K., "SALLAHU" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: